VENDIM
Nr. 145, datë 22.2.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIM URBAN SPILE, HIMARË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban Spile, Himarë".
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Himarë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "truall" dhe "objekt", me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 98 969 835.44 (nëntëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë pikë dyzet e katër) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 98 969 835.44 (nëntëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë pikë dyzet e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare".
7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Himarë.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LLOGARITJET PARAPRAKE TE PRONAREVE TE SHPRONESIMIT PER INTERES PUBLIK TE PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI URBAN SPILE, HIMARE"

Nr	Mbiemer	Emer	Lloj i pasurise	Nr. Hipotekore/Pasurie	Zone Kadastrale	Sip. Pergj. truallit m2	Sip. Prekur Truall m2	Cmimi i truallit Lekë	Vlera e trualiit lekë/m2	Sip. pergj. Objektit m2	Sip. e objektit që preket m2	Cmimi objektit Lekë/m2	Vlera e objektit lekë	Vlera totale per Truall + Objekt në Lekë	KONFIRMIMR NGA Z.V.R.P.P, VLORE
1	Bollano	Alfred	Banese/Truall		1952	93	93	4350	404550	93	93	56,673.72	5,270,656.0	5,675,205.96	Nuk disponon dokumentacion
2	Bollano	Alfred	Pemtore	316/11	1952	733	733	200	146600	0	0	56,673.72	0.0	146,600.00	Konfirmime Shkresa nr.22081/1, Prot. dt. 18/11/2016
3	Neranxi	Eleni	Banese	772	1952	0	0	4350	0	72	72	56,673.72	4,080,507.8	4,080,507.84	Konfirmime Shkresa nr.22081/1, Prot. dt. 18/11/2016
4	Neranxi	Perikli	Banese	773	1952	0	0	4350	0	142	142.00	56,673.72	8,047,668.2	8,047,668.24	Konfirmime Shkresa nr.22081/1, Prot. dt. 18/11/2016
5	Neranxi	Paxino	Banese/Truall	152	1952	35	35	4350	152250	111	111.00	56,673.72	6,290,782.9	6,443,032.92	Nuk disponon dokumentacion
6	Zoto	Mimi	Truall	565	1952	25	25	4350	108750	0	0.00	56,673.72	0.0	108,750.00	Konfirmime Shkresa nr.22081/1, Prot. dt. 18/11/2016
7	Dhimojani	Koco	Banese/Truall	38	1952	77	77	4350	334950	77	77.00	56,673.72	4,363,876.4	4,698,826.44	Konfirmime Shkresa nr.22081/1, Prot. dt. 18/11/2016
8	Rapo	Mihallaq	Banese		1952	174	174	4350	756900	237	237.00	56,673.72	13,431,671.6	14,188,571.64	Konfirmime Shkresa nr.22081/1, Prot. dt. 18/11/2016
9	Bashkpron. Andrea, Buli, Jani, Konomi dhe Kasiani Gjini		Banese		1952	215	215	4350	935250	430	430.00	56,673.72	24,369,699.6	25,304,949.60	Nuk disponon dokumentacion
10	Veizi	Panajot	Banese		1952	0	0	4350	0	43	43.00	56,673.72	2,436,970.0	2,436,969.96	Nuk disponon dokumentacion
11	Leka	Katina	Banese		1952	0	0	4350	0	72	72.00	56,673.72	4,080,507.8	4,080,507.84	Nuk disponon dokumentacion
12	Neranxi	Thoma	Banese/Truall		1952	18	18	4350	78300	18	18.00	56,673.72	1,020,127.0	1,098,426.96	Nuk disponon dokumentacion
13	Rondo	Andrea	Banese		1952	0	0	4350	0	14	14.00	56,673.72	793,432.1	793,432.08	Nuk disponon dokumentacion
14	Kacelano	Zaharia	Banese/Truall		1952	0	0	4350	0	18	18.00	56,673.72	1,020,127.0	1,020,126.96	Nuk disponon dokumentacion
15	Qiriaqi	Edmond	Truall		1952	0	0	4350	0	39	39.00	56,673.72	2,210,275.1	2,210,275.08	Nuk disponon dokumentacion
16	Dhimojani	Anest	Truall		1952	33	33	4350	143550	33	33.00	56,673.72	1,870,232.8	2,013,782.76	Nuk disponon dokumentacion
17	Dhimaleksi	Pano	Truall		1952	33	33	4350	143550	33	33.00	56,673.72	1,870,232.8	2,013,782.76	Nuk disponon dokumentacion

18	Cini	Apostol	Truall		1952	29	29	4350	126150	0	0.00	56,673.72	0.0	126,150.00	Nuk disponon dokumentacion
19			Banese		1952	120	120	4350	522000	120	120.00	56,673.72	6,800,846.4	7,322,846.40	Nuk disponon dokumentacion
20	Kacelano	Dino	Banese		1952	0	0	4350	0	40	40.00	56,673.72	2,266,948.8	2,266,948.80	Nuk disponon dokumentacion
21	Veizi	Elton	Banese		1952	0	0	4350	0	60	60.00	56,673.72	3,400,423.2	3,400,423.20	Nuk disponon dokumentacion
22	Veizi	Agron	Truall		1952	260	260	4350	1131000	0	0.00	56,673.72	0.0	1,131,000.00	Nuk disponon dokumentacion
23	Bollano	Familja	Truall		1952	83	83	4350	361050	0	0.00		0.0	361,050.00	Nuk disponon dokumentacion
									5,344,850					**98,969,835.44**	